

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikadur-Combiflex® SG-20 M

SHIRIT ME PERFORMANCË TË LARTË PËR IZOLIMIN E FUGAVE DHE PLASARITJEVE

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikadur-Combiflex® SG-20 M është shirit fleksibël për hidroizolim me bazë poliolefinë fleksibël të modifikuar (FPO) me veti të avancuara ndërkapjeje. Është pjesë e sistemit Sikadur-Combiflex® SG System.

PËRDORIMET

Izolim i të gjitha llojeve të fugave dhe plasaritjeve në shumë struktura dhe aplikime të ndryshme ku përfshihen:

- Tunele dhe tombino
 - Hidrocentrale
 - Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza
 - Bodrumet
 - Struktura ujëmbajtëse dhe rezervuarë uji të pijshëm
 - Përreth tubacioneve prej hekuri, çeliku dhe betoni
- Izolim i:
- Fugave të lëvizjes
 - Fuga të ndërtimit
 - Depërtimeve të tubave
 - Plasaritjeve
 - Pjesë të ndërtesës ku pritët cedim

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Ndërkapje e përmirësuar, nuk kërkohet aktivizim në kantier
- Fleksibilitet tepër i lartë
- Rezistencë e mirë ndaj shumë kimikateve të ndryshme
- Rezistencë ndaj ujit dhe kushteve të motit
- Rezistencë ndaj depërtimit të rrënjëve
- Rezistencë ndaj rrezatimit UV
- Performancë e mirë brenda një shkalle të gjerë temperaturash
- Pa plastifikues
- Mund të saldohet me ajër të nxehtë
- Mund të përdoret për kontaktin me ujin e pijshëm

MIRATIME / STANDARDE

- Raport testimi i performancës, Sistemi Sikadur-Combiflex SG, STUVA (Gjermani), Nr. 1640-KEBE-001
- Certifikata e ujit të pijshëm KTW, Sistemi Sikadur-Combiflex SG, Instituti i Higjienës (Gjermani), Cert No. K-248079-14
- Skema këshilluese për ujin e pijshëm - rregulloret për ujin (WRAS), raport testimi për përdorim me ujë deri në 50°C, Sistemi Sikadur-Combiflex SG, WRAS (UK), Cert No. 1708503
- Certifikata e ujit të pijshëm - higjienës, Sistemi Sikadur-Combiflex SG, Instituti Kombëtar i Higjienës (Poloni), Cert Nr. HK/W/0734/01/2017
- Certifikata për ujin e pijshëm - Attestation de conformite sanitaire (ACS), Sistemi Sikadur-Combiflex SG, CARSO (Francë), Cert Nr. 16 MAT LY 108
- Raport testimi i miratuar nga Polonia, Sistemi Sikadur-Combiflex SG, Instituti i Kërkimeve për Rugët dhe Urat për të gjitha Strukturat e Transportit dhe Komunikimit (Poloni), Nr. IBDiM-KOT-2018/0127
- Raport testimi i rezistencës ndaj depërtimit të rrënjëve CEN/TS 14416, Sikadur-Combiflex SG-10, SKZ (Gjermani), Nr. 89643/09
- Raport testimi i rezistencës ndaj grisjes ISO 34-1, Sikadur-Combiflex SG-20, Material Lab (Emiratet Arabe), Nr. 220533
- Raport testimi i zgjatimit dhe rezistencës ndaj tërheqjes ISO 527-1, Sikadur-Combiflex SG-20, Material Lab (Emiratet Arabe), Nr. 240405
- Raport testimi AS/NZS 4020:2005, Sistemi Sikadur-Combiflex SG, Laboratorët ams (Australi), Nr.1116525

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Poliolefinë fleksibël e modifikuar (FPO) me ndërkapje të përmirësuar
Ambalazhi	Shiriti i kuq maskues Trashësi: 2 mm Gjerësi: 15, 20, 25, 30 cm Rulona 25 m
Paraqitja / Ngjyra	Shiriti i mbështjellë në rulon me ngjyrë gri të lehtë dhe cilësi të njëtrajtshme. Shiriti Sikadur-Combiflex® SG-20 M: Membranë fleksibël ngjyrë gri e lehtë me shirit të kuq maskues për aplikim më të lehtë në fugat e zgjerimit.
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhen në ambalazhin original, të pahapur dhe të padëmtuar. Rulonat e hapur dhe të pambrojtur duhet të përdoren brenda 2 muajsh.
Kushtet e magazinimit	Të ruhen në vend të thatë e të freskët. Të mbrohen nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.

TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore D	35	[DIN 53505]
Rezistenca ndaj depërtimit të rrënjëve	Kalon	[CEN/TS 14416]
Rezistenca ndaj tërheqjes	>12 N/mm ²	[EN 12311-2]
Zgjatimi	>650 %	[EN 12311-2]
Rezistenca ndaj grisjes	>50 N/mm	[EN12310-2]
Rezistenca e tegelit	> 300N/5cm >400N/5cm	[EN 12316-2] [EN 12317-2]
Palosja në temperatura të ulëta	Pa plasaritje në -40°C Kalon	[EN 495-5]
Papërshkueshmëria e ujit	6 bar / 72 orë Sjellje nën presion hidrostatik	[EN 1928-B]
Rezistenca kimike	Testuar sipas EN 1847. Ju lutemi kontaktoni me Shërbimin Teknik Sika në lidhje me rezistencën kimike.	
Vjetrimi termik	Kalon	[SIA V280, 1996]
Rezistenca ndaj vjetritimit nga tensioni mjedisor	Vjetrim artificial nga kushtet e motit: kaluar 7500 orë	[EN ISO 4892-2/-3]
Reagimi ndaj zjarrit	Euroclass E	[EN ISO 11925-2, klasifikim i EN 13501-1]
Temperatura e funksionimit	-40°C min. deri në +60°C max	

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Ju lutemi këshillohuni me skedën teknike të sistemit Sikadur-Combiflex® SG.
----------------------	---

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Temperatura e mjedisit	0°C min. deri në +60°C max.
Temperatura e nënshtresës	+5°C min. deri në +45°C max. (të plotësohen kushtet e përdorimit të epoksidëve - adezivëve)

UDHËZIME APLIKIMI

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Përzgjedhja e madhësisë së shiritit:
Përzgjedhja e madhësisë së saktë të shiritit (trashësi dhe gjerësi) dhe adezivit të përshtatshëm Sika® varet nga performanca që pritet. Nëse është nevojshme, kërkoni këshilla teknike. Shiritat me trashësi 1 mm janë të përshtatshëm vetëm për izolimin e fugave që janë subjekt i ngarkesave të lehta.

Zgjatimi max. i lejueshëm i përhershëm:
Shirit 1 mm: 10% i gjerësisë së shiritit të pangjitur
Shirit 2 mm: 25% i gjerësisë së shiritit të pangjitur

Shënim: Për lëvizje më të mëdha, vendosni dhe fiksoni shiritin në formë të lugët brenda fugës.

Aplikimi i shiritit:
Ju lutemi këshillohuni me Method Statement të sistemit Sikadur-Combiflex® SG.

Bashkimi i shiritave Sika®-Combiflex® SG :

Fundet e shiritit bashkohen me saldim me ajër të nxehtë. **Zona ku do të bëhet saldimi duhet të përgatitet duke ashpërsuar sipërfaqen me letër smerile ose sfungjer të ashpër.**

Ashpërsoni shiritat vetëm në zonën ku do të saldohen dhe jo në vend tjetër sepse do të ndikohet ndërkapja e tyre.

KUFIZIME

Ju lutemi këshillohuni me skedën teknike të sistemit Sikadur-Combiflex® SG System dhe Method Statement

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Sika Albania SHPK
Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikadur-Combiflex® SG-20 M
Shkurt 2019, Botimi 01.01
020703150200000008

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sikadur-CombiflexSG-20M-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf